

# RAPORT MONITORIMI



## VLERËSIMI I AKTIVIZIMIT TË GRUPIT TË GJELBËR PRANË KUVENDIT TË SHQIPËRISË

Korrik 2024



ASP AKADEMIAE  
STUDIMEVE  
POLITIKE

# RAPORT MONITORIMI

VLERËSIMI I AKTIVIZIMIT TË GRUPIT TË GJELBËR  
PRANË KUVENDIT TË SHQIPËRISË

Korrik 2024



## **RAPORT MONITORIMI**

VLERËSIMI I AKTIVIZIMIT TË GRUPIT TË GJELBËR  
PRANË KUVENDIT TË SHQIPËRISË

Korrik 2024

### **PËRGATITI:**

Silvana Jaupaj

Copyright ASP 2024

### **AKADEMIA E STUDIMEVE POLITIKE**

Rruga "Emin Duraku", Pallati Credins Hyrja 1, kati 7, Ap. 21, Tiranë,  
Tel: +355 4 5629047, E-mail: [info@asp.al](mailto:info@asp.al), Web: [www.asp.al](http://www.asp.al)

# PËRMBAJTJA

|                                                                    |    |
|--------------------------------------------------------------------|----|
| <b>I. HYRJE</b>                                                    | 6  |
| Aktivitetet e Grupit të Gjëlber                                    | 6  |
| <b>II. NEVOJA PËR VLERËSIMIN E DEPUTETËVE TË GRUPIT TË GJELBËR</b> | 7  |
| Promovimi i deputetëve aktivë                                      | 7  |
| <b>III. METODOLOGJIA E PËRDORUR</b>                                | 8  |
| 1. Analizimi i politikave                                          | 8  |
| 2. Iniciativat e gjebra                                            | 8  |
| 3. Mbështetja dhe deklaratat publike                               | 8  |
| 4. Pjesëmarrja në punimet e Grupit të Gjëlber                      | 9  |
| 5. Angazhimi në zonat zgjedhore                                    | 9  |
| 6. Propozimet legjislative                                         | 9  |
| 7. Bashkëpunimi dhe netëorku                                       | 9  |
| 8. Praktikrat e qëndrueshme dhe carbon footprint                   | 9  |
| 9. Edukimi dhe ndërgjegjësimi                                      | 9  |
| 10. Monitorimi dhe raportimi                                       | 9  |
| 11. Feedback-u nga organizatat mjedisore                           | 9  |
| Pikëzimi                                                           | 10 |
| <b>IV. VLERËSIMI</b>                                               | 10 |
| Aneks – Përbërja e Grupit të Gjëlber                               | 13 |

## I. HYRJE

Agjenda e Gjëlber për Ballkanin Perëndimor është një strategji e re për zhvillimin e rajonit që kalon nga një model ekonomik tradicional në një ekonomi të qëndrueshme, në përputhje me Agjendën e Gjëlber Evropiane. Duke nënshkruar Deklaratën mbi Agjendën e Gjëlber, vendet e Ballkanit Perëndimor u angazhuan në Samitin e Sofjes më 10 nëntor 2020 për të zbatuar masa ndaj ndryshimeve klimatike, zhvillimit të energjisë, transportit dhe ekonomisë qarkulluese, si dhe mbrotjes së biodiversitetit, bujqësisë dhe prodhimit të qëndrueshëm.

Me synim rritjen e njohurive dhe bashkëpunimit të parlamentarëve me aktorë të ndryshëm institucionalë dhe civilë për zbatimin e objektivave të ndërmarra në kuadër të Agjendës së Gjëlber, pranë Kuvendit të Shqipërisë është themeluar Grupi i Gjëlber.

Grupi i Gjëlber është krijuar me urdhërin nr. 55 datë 16.06.2022 të Kryetares së Kuvendit, është konstituuar më 20 korrik 2022 dhe ka plotësuar strukturat e tij në shtator 2022. Në përbërje të tij ka deputetë të grupeve të ndryshme parlamentare dhe të komisioneve parlamentare, të cilët kanë në fokus të punës së tyre politikat e Bashkimit Europian mbi sektorin e energjisë, të transportit dhe mjedisit.

Pas disa ndryshimeve që ka pësuar përbërja e tij si pasojë e dorëzimit të mandatit të deputetit nga disa deputetë, apo emërimit në ekzekutiv të një deputeteje, aktualisht Grupi përbëhet nga 28 deputetë, të cilët kanë dhënë kontributin e tyre në nxitjen e përmbytjes së detyrimeve të Shqipërisë në kuadër të Agjendës së Gjëlber.

Falë koordinimit të Akademisë së Studimeve Politike (ASP), anëtarët e Grupit të Gjëlber janë angazhuar në nisma dhe bashkëpunime me parlamentarët në rajon mbi zhvillimin e qëndrueshëm të energjisë, mobilitetin urban dhe ndryshimet klimatike. Ky bashkëpunim rajonal mundësohet nga Qeveria Gjermane dhe Komisioni Evropian, në kuadër të Fondit të Hapur Rajonal për Evropën Juglindore-Energjisë, Transportit dhe Mbrojtjes së Klimës (ORF-ETC), i cili zbatohet bashkërisht nga Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH dhe Rrjeti i Shkollave të Studimeve Politike në Ballkanin Perëndimor.

### Aktivitetet e Grupit të Gjëlber



1. Konstituimi i Grupit dhe miratimi i Rregullores dhe Kalendarit të punimeve.



2. Zgjedhja e kryesisë së Grupit dhe miratimi i planit të punës.



3. Një përfaqësi e deputetëve të Grupit të Gjëlber e përbërë nga Arben Pëllumbi, Eduard Shalsi, Anila Denaj, Ferdinand Xhaferaj, zhvilloi një takim në ambjentet e Kuvendit me kreun e komisionit parlamentar gjerman për çështjet evropiane, z. Anton Hofreiter, i cili ndodhej për një vizitë pune në vendin tonë.



4. Pjesëmarrje e përfaqësuesve të Grupit të Gjëlber në mbledhjen e Plenumit Parlamentar të Komunitetit të Energjisë në Vjenë, deputetet Arben Pëllumbi, Helidon Bushati, Eduard Shalsi dhe Lefter Gështenja.



5. Anëtarët e Grupit të Gjellbër morën pjesë në një seancë informuese me temë "Transporti publik i gjellbër – politikat evropiane dhe incentivat e nevojshme në Shqipëri", të organizuar nga ASP dhe GIZ.



6. Në Javën Evropiane të Mobilitetit, Grupi i Gjellbër iu bashkua një aktiviteti për promovimin e lëvizjes me skutera elektrike, si një masë për reduktimin e ndotjes së ajrit në qytetin e Tiranës.



7. Deputeti i Grupit të Gjellbër dhe kryetari i Komitetit për Transportin dhe Mobilitetin, Z. Ferdinand Xhaferaj mori pjesë në një seminar me anëtarë të Grupeve të Gjellbra të vendeve të Ballkanit Perëndimor në Budva me temë "Marrëveshja e Gjellbër: Plani i Veprimit i Përbashkët".



8. Deputetët e Kuvendit, z. Ferdinand Xhaferaj dhe z. Alban Xhelili morën pjesë në një vizitë studimore pranë Sekretariatit të Komunitetit të Transportit në Beograd.



9. Grupi i Gjellbër organizoi në bashkëpunim me zëvendëskryetaren e Kuvendit, znj. Ermonela Felaj në Kryesinë e Kuvendit, një veprimtari shkencore me temë "Sistemet e informacionit gjeografik (GIS) në vendimmarrje".



10. U ftua drejtori i Sekretariatit të Komunitetit të Transportit Matej Zakonjsek për të prezantuar raportin vjetor dhe politikat kryesore për zhvillimin e transportit publik në një takim me Grupin e Gjellbër.

## II. NEVOJA PËR VLERËSIMIN E DEPUTETËVE TË GRUPIT TË GJELLBËR

Një prej objektivave të angazhimit të ASP pranë grupit të Gjellbër është dhe promovimi i deputetëve më aktivë në mbështetjen e politikave të gjellbra. Në këtë kuadër ASP ka iniciuar një vlerësim të aktivitetit të deputetëve anëtarë të Grupit të Gjellbër si një mënyrë për të parë se cila ka qenë ecuria e këtij grupi dhe çfarë nevojitet për përmirësimin e performancës së tij në angazhimin e tyre personal dhe politik.

ASP e ndërgjegjshme se vlerësimi i deputetëve në lidhje me kontributin e tyre në çështjet që lidhen me Agjendën e Gjellbër ndikon në përgjegjshmërinë mjedisore, në llogaridhënie, në impaktin e politikave, në ndërgjegjësimin publik, në promovimin e praktikave më të mira dhe në angazhimin e qëndrueshmërinë afatgjatë, beson se ky proces:

- Siguron që deputetët përmbushin përgjegjësitë e tyre dhe i japin përparësi qëndrueshmërisë mjedisore duke mundësuar të adresojnë çështje shqetësuese mjedisore;
- Ndihmon në identifikimin e aspekteve ku deputetët janë të suksesshëm dhe ku janë të nevojshme përmirësimet;
- Vlerëson efektivitetin e politikave mjedisore dhe identifikon aspekte për përmirësimin e tyre apo iniciativa të reja;
- Inkurajon angazhimin dhe mbështetjen për politika më mjedisore, si dhe kontribuon në rritjen e ndërgjegjësimin publik për këto çështje;

Në përgjithësi vlerësimi i deputetëve për çështje që lidhen me Agjendën e Gjellbër është thelbësor për promovimin e kujdesit ndaj mjedisit, sigurimin e përgjegjshmërisë mjedisore, forcimin e llogaridhënies, si dhe orientimin drejt ndryshimeve pozitive për planetin dhe brezat e ardhshëm.

### Promovimi i deputetëve aktivë

Promovimi i deputetëve më aktivë përfshin njohjen dhe theksimin e përpjekjeve të tyre, duke inkurajuar angazhimin e vazhdueshëm të tyre dhe duke mbështetur një mjedis që vlerëson dhe shpërblen përfaqësimin efektiv. Ky promovim mund të bëhet nëpërmjet:

- Njohjes publike që përfshin mbulimin mediatik të aktiviteteve të tyre;
- Histori dhe profile pozitive në platforma mediatike e sociale që ndikojnë në njohjen e kontributit të tyre;
- Mbështetje me ekspertizë në nismat e tyre;
- Angazhimin në forume ndërkombëtare ku trajtohen çështjet e Agjendës së Gjellbër;
- Përfshirja në fushata nërgjegjëse; etj.

## III. METODOLOGJIA E PËRDORUR

Performanca e deputetëve të grupit të gjellbër nuk mund të matet vetëm në aktivitetet e zhvilluara nga Grupi i Gjellbër, por duhet marrë në konsideratë edhe performanca e tyre në aktivitetin parlamentar, për aq sa ky aktivitet lidhet me çështjet e përfshira në Agjendën e Gjellbër që fokusohen kryesisht në nxitjen e marrjes së masave ndaj ndryshimeve klimatike, zhvillimit të sektorit të energjisë, transportit dhe ekonomisë qarkulluese, si dhe mbrojtjes së biodiversitetit, bujqësisë dhe prodhimit të qëndrueshëm.

Ky vlerësim është fokusuar tek mbledhja sistematike e të dhënave, analiza dhe përdorimi i informacionit nga veprimtaria ligjvënëse, kontrolluese dhe zgjedhëse parlamentare, si dhe aktivitetet parlamentare e ato të organizuara në bashkëpunim me shoqërinë civile e organizma të tjerë në kuadër të veprimtarisë së Grupit të Gjellbër.

Duke theksuar aspektet kryesore, procesi i vlerësimit mund të sigurojë një ide të qartë dhe me nuanca të angazhimit të deputetit dhe kontributit të tij në çështjet e Agjendës së Gjellbër. Kjo qasje siguron një vlerësim që shkon përtej aktivitetit ligjvënës për të përfshirë mbështetjen, angazhimin në komunitet dhe praktikën personale. Elementët kryesorë të vlerësimit të angazhimit të deputetëve të Grupit të Gjellbër mund të konsiderohen:

### 1. Analizimi i politikave

- Votimi në mbështetje të legjislacionit që lidhet me ruajtjen e mjedisit, energjitë e rinovueshme, zbutjen e ndryshimeve klimatike, dhe politika të tjera të gjelbra.
- Vlerësimi i qëndrimeve mbi çështjet kryesore mjedisore si, ulja e emetimit të karbonit, ruajtja e biodiversitetit dhe zhvillimi i qëndrueshëm.

### 2. Iniciativat e gjelbra

- Vlerësimi i çdo iniciative apo projekti i prezantuar apo mbështetur nga deputetët që promovon qëndrueshmëri mjedisore në zonat e tyre elektorale.
- Vlerësimi i përpjekjeve të tyre për të rritur vëmendjen ndaj praktikave miqësore me mjedisin dhe promovimin e tyre në zonat e tyre.



### 3. Mbështetja dhe deklaratat publike

- Analizimi i deklarimeve publike të deputetëve dhe fjalime që lidhen me Agjendën e Gjelbër, si në parlament ashtu edhe në aktivitetet jashtë tij.
- Vlerësimi i përfshirjes së tyre në forume kombëtare e ndërkombëtare që adresojnë shqetësime për mjedisin si, me Komunitetin e Energjisë në Vjenë dhe plenumin parlamentar të tij, ku përfaqësohet dhe Kuvendi i Shqipërisë, ashtu dhe me Komunitetin e Transportit në Beograd, dhe në ato rajonale.

### 4. Pjesëmarrja në punimet e Grupit të Gjelbër

- Vlerësimi i pjesëmarrjes së deputetëve në aktivitetet e Grupit të Gjelbër, si dhe vlerësim i impaktit të kontributit të tyre në formësimin e politikave të gjelbra në aktivitetet e Grupit të Gjelbër, mbeten të rëndësishme për të analizuar vlerësimin dhe kompaktësimin e tij në ndërmarrjen e iniciativave të ndryshme.

### 5. Angazhimi në zonat zgjedhore

- Vlerësimi se si deputetët angazhohen me zgjedhësit në çështjet mjedisore. Kjo mund të përfshijë takime, fushata ndërgjegjësimi, dhe bashkëpunim me organizatat mjedisore.
- Vlerësim i reagimit të tyre ndaj shqetësimeve mjedisore të zgjedhësve, shqetësime të cilat i ngrenë në seancat plenare në çështje jashtë rendit të ditës apo në interpelanca.

### 6. Propozimet legjislative

- Vlerësimi i çdo projektligji apo mocioni që ka në fokus avancimin e Agjendës së Gjelbër i propozuar nga deputetët, duke konsideruar rëndësinë dhe potencialin e ndikimit të këtyre propozimeve.

### 7. Bashkëpunimi dhe netëorku

- Vlerësimi i deputetëve për bashkëpunimin me deputetët të tjerë, trupat qeveritare dhe organizatat joqeveritare që kanë në fokus çështjet mjedisore.
- Vlerësimi i aftësisë së tyre për të ndërtuar aleanca për avancimin e politikave të gjelbra.

### 8. Praktikrat e qëndrueshme dhe carbon footprint

- Ekzaminim i praktikave personale dhe parlamentare të deputetëve në lidhje me qëndrueshmërinë e mjedisit të tilla si reduktimi i gjurmës së karbonit, reduktimi i mjetjeve dhe ruajtja e energjisë.

### 9. Edukimi dhe ndërgjegjësimi

- Vlerësim i përpjekjeve të bëra nga deputetët për të edukuar zgjedhësit e tyre në lidhje me rëndësinë e qëndrueshmërisë mjedisore dhe Agjendën e Gjelbër.
- Konsiderimi i çdo iniciative që promovon praktika të qëndrueshme brenda komunitetit.

### 10. Monitorimi dhe raportimi

- Vlerësimi i angazhimit të deputetëve në monitorimin dhe raportimin e progresit në qëllimet e objektivat mjedisore.
- Vlerësimi i transparencës së tyre në raportimin e arritjeve, sfidave dhe planeve të ardhshme që lidhen me Agjendën e Gjelbër.

## 11. Feedback-u nga organizatat mjedisore

- Konsiderimi i *feedback-ut* të grupeve dhe organizatave që mbështesin mejdisin lidhur me angazhimin e deputetëve në Agjendën e Gjellbër.
- Në qasje të këtyre elementeve, ASP ka gjykuar se për të siguruar një vlerësim të plotë të performancës së deputetëve të Grupit të Gjellbër, ai duhet të jetë gjithëpërfshirës dhe të marrë parasysh aspekte të ndryshme të veprimtarisë së tyre.

Në vlerësim të sa më sipër, Metodologjia e përdorur në vlerësimin e deputetëve të Grupit të Gjellbër për periudhën e parë të funksionimit të tij që shtrihet nga korriku i vitit 2022 e deri në korrik të vitit 2024 bazohet si në dimensionet e performancës parlamentare, siç janë diskutimet në seancat e komisioneve parlamentare dhe në seancat plenare, pyetjet e drejtuara në seancat e komisioneve parlamentare dhe në seancat plenare, Interpelancat e kërkuara, amendamentet e bëra në shqyrtimin e akteve ligjore dhe nismat ligjore të propozuara, për sa ato lidhen me çështjet e Agjendës së Gjellbër, çështjet e ngritura nga komuniteti i zonave që përfaqësojnë në seancat për javën e gjellbër, ashtu dhe në aspekte të veprimtarisë së vetë Grupit të Gjellbër duke përfshirë pjesëmarrjen në aktivitetet e tij, diskutimet e pyetjet në këto aktivitete.

Një tjetër element i përfshirë është edhe ftesa për pjesëmarrjen e shoqërisë civile në veprimtarinë parlamentare për çështje që lidhen me Agjendën e Gjellbër duke e pare si shumë të rëndësishëm bashkëpunimi mes tyre.

Ndërkohë, për shkak se momenti kur u mor vendimi për këtë vlerësim mund të konsiderohet i vonë në kohë, ASP gjykoi që elementë të përmendur më lart të cilët lidhen me veprimtarinë e deputetit jashtë agjendës parlamentare, si fushatat ndërgjegjësuere në komunitet; veprimtaritë në zonat elektorale; vlerësimet, promovimet, debatet në media sociale e media, etj; nuk është e mundur të jenë pjesë e këtij vlerësimi të parë të performancës së deputetëve të Grupit të Gjellbër.

### Pikëzimi

Metodologjia për vlerësimin e aktivizimit të deputetëve të Grupit të Gjellbër është zbërthyer në elementët dhe pikëzimin si më poshtë:

- Pjesëmarrja në aktivitetet e Grupit të Gjellbër vlerësohet me 1 pikë për çdo aktivitet;
- Angazhimi në debate dhe diskutime në aktivitetet e Grupit të Gjellbër, komisionet parlamentare dhe seancat plenare, vetëm për çështje të përfshira në agjendën e gjellbër vlerësohet me 3 pikë për diskutim/debatim;
- Angazhimi në kontrollin parlamentar në procesin legjislativ dhe atë kontrollues në aktivitete e Grupit të Gjellbër, mbledhjet e komisioneve parlamentare përkatëse dhe në seancë plenare vlerësohet me 2 pikë për çdo pyetje;
- Angazhimi në kontrollin parlamentar nëpërmjet interperlancave në seancat plenare vlerësohet me 4 pikë;
- Angazhimi për të përfshirë organizatat joqeveritare që operojnë në fushën e mjedisit gjatë shqyrtimit të legjislacionit që lidhen me çështje të Agjendës së Gjellbër në komisione e veprimtaritë e Grupit të Gjellbër, vlerësohet me 2 pikë;
- Angazhimi në propozimin e amendamenteve në komisionet parlamentare apo në seancë plenare në shqyrtimin e nismave që lidhen me çështje të Agjendës së Gjellbër vlerësohet me 4 pikë për çdo amendament;
- Angazhimi në propozimin e nismave ligjore që lidhen me çështje të Agjendës së Gjellbër dhe mbrojtjen e tyre në komisionet parlamentare vlerësohet me 5 pikë për çdo nismë.

## IV. VLERËSIMI

Në përfundim të vlerësimit u konstatua se deputetët më aktivë të Grupit të Gjelbër janë:



Arben Pëllumbi



Ismet Beqiraj



Lefter Gështenja



Xhelal Mziu



Helidon Bushati



Eduard Shalsi



Ferdinand Xhaferaj



Emilja Koliqi

Gjatë këtij procesi, duke u kufizuar vetëm tek angazhimi në diskutime, pyetje, interpelanca, amendamente e nisma ligjore, u vlerësua edhe aktivizimi sipas fushave të përgjegjësisë së Komiteteve të Grupit të Gjellbër, ku u konstatua se:


- në çështjet e mjedisit dhe klimës deputetët më aktivë janë deputetët, Ismet Beqiraj (96), Arben Pëllumbi (54) dhe Helidon Bushati (44);
- në çështjet e Energjisë deputetët më aktivë janë Lefter Gështenja (72), Arben Pëllumbi (59), Xhelal Mziu (56), Helidon Bushati (46);
- në çështjet e transportit deputetët më aktivë janë Ferdinand Xhaferaj (34) e Emilja Koliqi (30).

Më poshtë renditja e deputetëve sipas pikëve

|     |                    |            |     |                    |           |
|-----|--------------------|------------|-----|--------------------|-----------|
| 1.  | Arben Pëllumbi     | <b>146</b> | 15. | Laert Duraj        | <b>29</b> |
| 2.  | Ismet Beqiraj      | <b>145</b> | 16. | Baftjar Zeqaj      | <b>26</b> |
| 3.  | Lefter Gështenja   | <b>134</b> | 17. | Luljeta Bozo       | <b>22</b> |
| 4.  | Xhelal Mziu        | <b>110</b> | 18. | Ina Zhupa          | <b>17</b> |
| 5.  | Helidon Bushati    | <b>108</b> | 19. | Ilir Ndraxhi       | <b>16</b> |
| 6.  | Eduard Shalsi      | <b>68</b>  | 20. | Agron Duka         | <b>16</b> |
| 7.  | Ferdinant Xhaferaj | <b>57</b>  | 21. | Anduel Tahiraj     | <b>15</b> |
| 8.  | Emilja Koliqi      | <b>57</b>  | 22. | Tatjana Piro       | <b>12</b> |
| 9.  | Sorina Koti        | <b>50</b>  | 23. | Dashnor Sula       | <b>10</b> |
| 10. | Petro Koçi         | <b>41</b>  | 24. | Ilirian Pendavinji | <b>9</b>  |
| 11. | Enslemvera Zake    | <b>38</b>  | 25. | Blerina Gjylameti  | <b>7</b>  |
| 12. | Nusret Avdulla     | <b>38</b>  | 26. | Erisa Xhixho       | <b>4</b>  |
| 13. | Fadil Nasufi       | <b>37</b>  | 27. | Ervin Salianji     | <b>4</b>  |
| 14. | Ramadan Likaj      | <b>32</b>  | 28. | Orjola Pampuri     | <b>2</b>  |

*\*Anila Denaj ka marrë detyrën e ministres pas krijimit të grupit*

## RENDITJA E DEPUTETËVE



Siç shihet, deputetët më aktivë janë deputetët anëtarë të Komisionit për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin dhe kjo mund të duket se përbën avantazh ndaj deputetëve të komisioneve të tjera, por nga procesi i vlerësimit është konstatuar se shumica e çështjeve janë shqyrtuar si tek ky Komision ashtu edhe tek Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut dhe Komisioni për Ekonominë dhe Financat, dhe në rastet e marrëveshjeve ndërkombëtare edhe tek Komisioni për Politikën e Jashtme. Gjithashtu, pjesëmarrja në aktivitetet me Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë dhe Sekretariatit e Komunitetit të Transportit, mbledhjet kanë qenë të përbashkëta me Grupin e Gjelbër.

Pjesëmarrja dhe aktivizimi vetëm në agjendën e Grupit të Gjelbër është një tjetër element që është mbajtur në vëmendje në këtë proces vlerësimi. Në këtë kuadër deputetët më aktivë vlerësohen Arben Pëllumbi, Ferdinand Xhaferaj, Eduard Shalsi, Ilir Ndraxhi, Lefter Gështhenja.

Në respekt të ndjeshmërisë ndaj çështjeve gjinore, nga ky vlerësim konstatohet se ndër deputetet gra anëtare të Grupit të Gjelbër si më aktivet janë vlerësuar Emilja Koliqi, Sorina Koti, dhe Enslemvera Zake.

Gjatë kryerjes së këtij procesi vlerësimi, përveç anëtarëve të Grupit të Gjelbër, u identifikuan edhe disa deputetë me kontribut në çështjet e Agjendës së Gjelbër edhe pse jo anëtarë të Grupit të Gjelbër. Këtu mund të përmendim deputetët:

**Petrit Vasili**, për propozimin e dy nismave ligjore në legjislacionin në fushën e energjisë në mbështetje të shtimit të energjisë së prodhuar nga burimet e rinovueshme dhe lehtësimit të furnizimit me energji në vend;

**Erion Braçe**, i cili ka kontribuar në nxitjen e çështjeve që lidhen me bujqësinë dhe mjedisin;

si dhe kontributi i deputetëve **Jorida Tabaku, Eduart Ndreca, Luan Baçi**, etj.

Përtej këtij vlerësimi, inkurajohet që deputetët e Grupit të Gjelbër të ndërmarrin nisma të mëtejshme ligjore si pjesë e kompetencave të tyre parlamentare, duke nxitur në këtë mënyrë edhe përsheptimin e mëtejshëm të veprimtarisë ligjore të ministrive të linjës në kuadër të Agjendës së Gjelbër.

## Aneks – Përbërja e Grupit të Gjellbër

Grupi i Gjellbër përbëhet nga deputetët:

|                  |                    |
|------------------|--------------------|
| Agron Duka       | Tatjana Piro       |
| Anduel Tahiraj   | Xhelal Mziu        |
| Anila Denaj      | Eduard Shalsi      |
| Arben Pëllumbi   | Erisa Xhixho       |
| Baftjar Zeqaj    | Petro Koçi         |
| Enslemvera Zake  | Blerina Gjylameti  |
| Fadil Nasufi     | Ilirian Pendavinji |
| Helidon Bushati  | Ervin Saliانji     |
| Ilir Ndraxhi     | Dashnor Sula       |
| Ismet Beqiraj    | Ferdinand Xhaferaj |
| Laert Duraj      | Sorina Koti        |
| Lefter Gështenja | Emilja Koliqi      |
| Luljeta Bozo     | Orjola Pampuri     |
| Nusret Avdulla   | Ina Zhupa          |
| Ramadan Likaj    |                    |

Kryetar i Grupit është zgjedhur z. Arben Pëllumbi dhe deputetët janë të ndarë në 3 Komitete si më poshtë:

**Komiteti për Çështjet e Energjisë**, i kryesuar nga Helidon Bushati

**Komiteti për Transportin dhe Mobilitetin**, i kryesuar nga Ferdinand Xhaferaj

**Komiteti për Mjedisin dhe Klimën**, i kryesuar nga Eduard Shalsi

Përkatësia sipas komisioneve parlamentare ku bëjnë pjesë këta deputetë është si më poshtë:

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin – 15 deputetë;

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut – 3 deputetë;

Komisioni për Ekonominë dhe Financat – 6 deputetë;

Komisioni për Politikën e Jashtme – 1 deputet;

Komisioni për Sigurinë Kombëtare – 1 deputet;

Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë – 2 deputetë;

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik – 1 deputet.





# RAPORT MONITORIMI



VLERËSIMI I AKTIVIZIMIT TË GRUPIT TË GJELBËR  
PRANË KUVENDIT TË SHQIPËRISE

Korrik 2024